

BASHKIA ELBASAN**NJOFTIM PER DHENIE ME QIRA**

Dhënien në përdorim të fondit pyjor publik, për mbarështrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, të ndarë në lote:

- Loti i parë: për sasinë totale prej 80 (tetëdhjetë) ha.
- Loti i dytë: për sasinë totale prej 132 (njëqind e tridhjetë e dy) ha.

Ne mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", neni 64.V.K.M nr.433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedist e të ish komunave /bashkive", Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", (pika 5, gërma "ç" e Kreut V), i ndryshuar. Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik". Vendimin e Këshillit Bashkiak Elbasan nr.08, datë 24.01.2019 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor publik, për mbarështrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme".

URDHEROJ

1. Të zhvillohet procedura për dhënien në përdorim të fondit pyjor publik, për mbarështrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, të ndarë në lote:
 - Loti i parë: për sasinë totale prej 80 (tetëdhjetë) ha.
 - Loti i dytë: për sasinë totale prej 132 (njëqind e tridhjetë e dy) ha.
2. Dhënien me qira të fondit pyjor publik, të bëhet me qellim për dhënien në përdorim të fondit pyjor publik, për mbarështrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme
3. Vlera fillestare e ndarë në lote:
 - Loti i parë: 1 600 000 (Njëmilion e gjashtëqind mijë) Lekë/vit, pa T.V.SH.
 - Loti i dytë: 2 640 000 (dy milion e gjashtëqind e dyzet mijë) Lekë/vit, pa T.V.SH
4. Data e zhvillimit të procedurës: 10.04.2019, ora 11.00
5. Vendi i zhvillimit të konkurimit (Adresa): Zyrat e Drejtorisë së Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Vetrinare dhe Mjedisit (Lagje "Dyli Haxhire Myzyri", ish Ndërmarrja e Ujshpërhapësive "ELBER" Elbasan.
6. Vlerësimi i ofertave të konkurrentëve do të bëhet me piket si vijon:
 - projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë;
 - planbiznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë;
 - planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë;
 - nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë;
 - masën e qirasë për ha/vit 35 pikë

7. Afati I dhenies me qera eshte 9 vjet

8. Konkurrentet do te paraqesin para komisionit ne daten dhe oren e caktuar dokumentacionin si vijon:

- Kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- nivelin e punësimit në veprimtari;
- çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- adresën e subjektit, telefon, email dhe faks.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim, janë:
- garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve

9. Informacion mbi proceduren:

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë Zyrave të Bashkisë Elbasan, Lagjja “Dyli Haxhire Myzyri”, ish Ndërmarrja e Ujsjellëskanalizimeve “ELBER”, Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Vetrinare dhe Mjedisit, kundrejt pagesës përkatëse.

Dokumente me pagesë:

Po X Jo ☐

Nëse Po

Monedha Lekë Çmimi 1000

Dokumentet përbëhen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit te fituesit;
- Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit;
- Procesverbal/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.

10. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët blerës në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar te konkurimit